



Raport Monitorimi
i
Strategjisë për Menaxhimin e Riskut,

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

SHTATOR 2017

1. Hyrje.....	3
2. Qëllimi	4
3. Forma e raportimit.....	4
4. Periudha e raportimit dhe afate kohore të raportimit	4
5. Procedurat e përgatitjes së raportit	5
6. Raporti deskriptiv.....	5
6.1. Risqe të Jashtme të përbashkëta për të gjithë departamentet e auditimit	6
6.2 Risqe të reduktuara në çdo departament auditimi.....	7
6.3 Risqe të shtuara për çdo departament auditimi.....	7
6.4 Elementë të shtuar të risqeve.....	7

1. Hyrje

Strategjia e Menaxhimit të Riskut ofron një qasje të strukturuar dhe koherente për identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e riskut në Kontrollin e Lartë të Shtetit .

Në Mars 2015, Kontrolli i Lartë i Shtetit miratoi Strategjinë e Menaxhimit të Riskut, qëllimi i të cilës *është të sigurojë që koncepti i menaxhimit të riskut të jetë në themel të kulturës organizative nëpërmjet filozofisë së zvogëlimit të riskut dhe vlerësimit të tij*, për çdo veprimtari që kryen institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut në KLSH reflekton të gjitha kërkesat e ISSAI 9130 “Udhëzues për Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik- Informacion i zgjeruar për Menaxhimin e Riskut Institucional” , Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ”Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” si dhe referohet përgjegjësive dhe objektivave të vendosura në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2013-2017, të rishikuar.

Për një menaxhim të riskut sa më efektiv KLSH synon që ta kthejë atë të në pjesë e kulturës së saj organizative të integruar në planet dhe veprimtaritë e përditshme të punës.

Menaxhimi I riskut nuk shikohet si një program i shkëputur, por duhet të bëhet përgjegjësi e çdo punonjësi në KLSH, të çdo niveli deri në hierarkinë më të lartë drejtuese.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut fokusohet si në risqet e nivelit strategjik ashtu dhe ato operacional.

Qëllimi i Strategjisë është të sigurojë që koncepti i menaxhimit të riskut të jetë në themel të kulturës organizative nëpërmjet filozofisë së zvogëlimit të riskut dhe vlerësimit të tij, për çdo veprimtari që kryen institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut në Kontrollin e Lartë të Shtetit jep një qasje gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar riskun e institucionit. Ajo synon të ndërtojë dhe të nxisë zhvillimin duke u bazuar në rishikime të rregullta dhe procese të përditësimit të vlerësimeve.

Urdhrit nr 41 , datë 30.03.2015 i Kryetarit të KLSH-së përcakton mënyrën e monitorimit e Strategjisë së Riskut institucional të KLSH-së. Ky monitorim paraqet vlerësimin e riskut me të cilën përballen KLSH si institucion auditues dhe vlerësimin e riskut me të cilin përballen departamentet e veçanta të auditimit. Veprimtaria e audituesit të jashtëm publik realizohet në kushte të një ndryshimi të vazhdueshëm të mjedisit të jashtëm, faktor kryesor ndryshimi i të cilit janë vetë audituesit e jashtëm publik.

Monitorimi periodik vjetor dhe përditësimi i perceptimit për riskun është jo vetëm një obligim, por dhe një domosdoshmëri në rrugëtimin për të qenë të suksesshëm në arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Qëllimi

Monitorimi i Strategjisë së Menaxhimit të Riskut kryhet në bazë të observimit të rregullt dhe regjistrimit të procesit të menaxhimit të riskut.

Qëllimi i Raportit të Monitorimit të Strategjisë së Riskut përfshin:

1. Analizën e situatës aktuale dhe progresit të bërë krahasuar më periudhën e mëparshme të monitoruar
2. Vlerësimin nëse po veprohet në linjë dhe drejt objektivave të caktuar
3. Identifikimin e problemeve lidhur me menaxhimin e riskut të tilla si : identifikimin e risqeve të reja dhe vlerësimin e tyre, rivlerësimin e risqeve ekzistuese;
4. Përcaktimin e veprimeve të mëtejshme bazuar në eksperiencën e mëparshme dhe studimin për periudhat e ardhme;

Qëllimi i këtij monitorimi është vlerësimi i risqeve dhe detajimi i masave në funksion të riorganizimit dhe ndryshimit të mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm.

Matrica e Risqeve përkatëse shpreh risqet e rivlerësuara, duke rishikuar dhe përshtatur planin e masave.

Rivlerësimi i risqeve i shërben ndërgjegjësimit të menaxhimit të lartë, duke adresuar veprimet që duhet të ndërmerren për shmangien e ngjarjeve të rastit të padëshiruara. Në nivel departamenti ai i shpërben stafit auditues për të rritur cilësinë e punës audituese, duke përmirësuar procedurat e planifikimit të auditimit dhe të përjasjes së subjekteve të audituara. Vlerësimi i Riskut do të shërbejë si bazë informacioni për të hartuar Strategjinë e Zhvillimit të KLSH për periudhën 2018 -2022.

Forma e raportimit

Raporti i Monitorimit të Strategjisë është konceptuar si një dokument deskriptiv në të cilin përshkruhen risqet e identifikuara, mënyrën se si ato kanë ndryshuar gjatë periudhës, po ashtu dhe pasqyrojnë elementet e rinj të riskut të perceptuar.

Regjistri i Riskut, është dokumenti i projektuar në formën e matricës monitoruese, në të cilin evidentohet informacion mbi riskun e identifikuar, riskun e qenësishëm (para kontrolleve) dhe riskun pas kontrolleve. Vlerësimi i këtij të fundit evidenton gjithashtu nevojën për kontrolle të mëtejshme.

Matrica e Regjistrimit të Riskut evidenton zotëruesin e riskut, nga buron ai dhe evidenton veprimet e mundshme për të adresuar problemet. Në këtë matricë janë përditësuar risqet e të gjithë departamenteve, në bashkëpunim më të dhënat mbi këtë perceptim nga Drejtorët e Departamenteve.

Periudha e raportimit dhe afate kohore të raportimit

Monitorimi është kryer si një proces periodik, i rregullt dhe sistematik dhe përfshin periudhë një vjeçare. Monitorimi i risqeve është nga përditësimi i fundit të regjistrimit të riskut. Gjatë një periudhe pasuese në bashkëpunim me stafin menaxherial, por edhe audituesit me eksperiencë në KLSH, nën drejtimin e Kryetarit, realizohet përditësimi integral i të gjithë risqeve. Ky përditësim prek periudhën Qershor 2016 deri në Qershor 2017.

Procedurat e përgatitjes së raportit

Përgatitja e Raportit të monitorimit të Strategjisë së Riskut të KLSH ka ndjekur rrjedhën e procedurave sipas përcaktimeve dhe përgjegjësi në Urdhrin e Kryetarit të KLSH për këtë qëllim nr. 41 datë.

Procedura për inicimin nis nga Sekretari i Përgjithshëm, Koordinator i Riskut dhe Ekipi për Menaxhimin e Riskut. Procesi është zhvilluar në dy drejtime : nga lart poshtë dhe nga poshtë lart. Perceptimi dhe përpilimi i raportit është realizuar në hap të parë në secilin departament dhe drejtori në bashkëpunim me Ekipin e Menaxhimit të Riskut.

Informacioni është konsoliduar më parë në nivel Departamenti dhe më tej në nivel institucional nga Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit, për t'u prezantuar me këtë Raport Përfundimtar të Monitorimit.

3. Raporti deskriptiv

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vendosur objektiva të qarta për periudhën strategjike katërvjeçare, dhe rritja e sigurisë për arritjen e tyre kërkon menaxhimin e realizimit të objektivave. Kjo i kushtëzon KLSH vendosjen dhe zotërimin e një metode të koordinuar dhe të planifikuar ndaj menaxhimit të rrezikut, identifikimit, analizimit dhe reagimit ndaj rreziqeve me të cilat ballafaqohet KLSH. Këtu merr fillësat Politika e Menaxhimit të Riskut e cila kërkon që të shqyrtohet jo vetëm natyra e rreziqeve por dhe kuptimi i koncepteve kryesore të menaxhimit të riskut.

Zhvillimet globale tregojnë se të gjithë sektorët e ekonomisë, dhe në mënyrë të veçantë sektori publik po fokusohet në menaxhimin e riskut si çelësi për të qenë të suksesshëm në ofrimin e objektivave.

Risku karakterizon çdo veprimtari që kryen njeriu në shoqëri, ekonomi, politikë, arsim shkencë, shëndetësi, rend, turizëm, infrastrukturë, etj. Çdo risk është specifik d.m.th. ka natyrën e tij : përmasat, densitetin (i lartë, i mesëm, i ulët), ndikimin, masën e humbjeve (dëmtimeve), etj. Risku në sistem përcaktohet nga natyra e proceseve, objekteve dhe struktura (infrastruktura)...për të menaxhuar riskun në sistem, duhet bërë menaxhimi i proceseve eventualisht në objekte ose/edhe në strukturat përkatëse.

Risku është pasiguria e rezultatit, dhe një menaxhim i mirë i riskut lejon :

- Të rritet besimin në arritjen e rezultateve të dëshiruara
- Të trajtohen kërcënimet në mënyrë efektive në nivele të pranueshme; dhe
- Të merren vendime të informuara mbi shfrytëzimin e mundësive.

Menaxhimi i mirë i riskut u lejon grupeve të interesit të rrisin besimin në qeverisjen organizative të organizatës dhe aftësinë ofruese të saj.

Menaxhimi i riskut konceptohet si tërësia e proceseve të përfshira në identifikimin, vlerësimin dhe gjykimin e risqeve, përcaktimin e përgjegjësisë, ndërmarrjen e veprimeve për zvogëlimin apo parashikimin e tyre, si dhe monitorimin dhe rishikimin e progresit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit e konsideron Menaxhimin e Riskut si balancim të një numri elementesh të ndërthurur të cilët ndërveprojnë me njëri tjetrin dhe të cilët nëse kërkohet që menaxhimi i riskut të jetë efektiv, duhet të jenë në ekuilibër me njëri tjetrin. Për më tepër, risqe të veçanta nuk mund të adresohen/trajtohen të izoluar nga njëri tjetri, menaxhimi i një risku mund të ketë impakt mbi një risk tjetër apo dhe veprimet e menaxhimit të cilat kanë efekt në kontrollin e më shume se të një risku të

vetëm është e vështirë të jenë njëkohësisht dhe të arritshëm.

Modeli si një i tërë funksionon në një ambient në të cilin është përcaktuar dëshira për risk/oreksi për risk. Koncepti i dëshirës/oreksit për risk (sa është risku i tolerueshëm apo i justifikuar) mund të konsiderohet si “një mbulesë” gjatë gjithë këtij modeli.

Një fazë e veçantë për një risk të veçantë në proces nuk do të jetë domosdoshmërisht e njëjtë për të gjitha risqet.

Thelbi i procesit të menaxhimit të riskut nuk është i izoluar, por ndodh në një kontekst dhe duhet të jepen disa inpute kyç në procesin e përgjithshëm me qëllim që të gjenerohen rezultatet e pritshme nga manaxhimi i riskut.

Realizimi i politikës së menaxhimit të riskut përfshin disa parakushte të cilat përbejnë një detyrim që lidhet me implementimin e suksesshëm të saj, të cilat janë:

1. Detyrim i drejtuesve është monitorimi dhe verifikimi periodik i risqeve që kërcënojnë realizimin e qëllimeve kryesore strategjike.
2. Personat përgjegjës për menaxhimin e riskut duhet të kenë kualifikimin e nevojshëm për identifikimin e riskut dhe për vlerësimin e tij.
3. Punonjësit kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.
4. Çdo veprim i punonjësit i cili ka për qëllim marrjen përsipër të përgjegjësisë për riskun do të vlerësohet dhe sipas gjykimit të mbështetet nga drejtuesit.
5. Raportimi për çdo lloj ngjarje, si pozitive, ashtu dhe negative është detyrim i çdo punonjësi.

4. Përshkrimi i ndryshimeve kryesore në identifikimin dhe vlerësimin e riskut

4.1. Risqe të Jashtme të përbashkëta për të gjithë departamentet e auditimit

Elementi i riskut të dimensionit Politik në matricën e regjistrit të riskut është zmadhuar. Mosndërgjegjësimin dhe inertësinë e administratës shtetërore është rivlerësuar në rritje nga 60 (i mesëm) në 70 (i mesëm). Ky risk ka influencë negative në zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, me efekt negativ në përmirësimin e veprimtarisë së subjekteve të audituara. Ky risk vlerësohet i mesëm për shkak të rritjes së transparencës, publikimit të rezultateve të auditimit, trajtimi i letrave të popullit, botimet dhe rritja e prezencës së KLSH në media konsiderohen si objektiva të duhur për mitigimin e këtij risku.

Elementi i riskut të dimensionit Teknologjik në matricën e regjistrit të riskut është zvogëluar. Përmirësimi i sistemeve të ruajtjes së dhënave dhe *e-government* janë faktorë të reduktimit të këtij risku, e mbështetur gjithashtu në forcimi i auditimit të teknologjisë së informacionit nga trupa audituese e KLSH-së.

Elementi i riskut të dimensionit social është redukuar nga 90 (i lartë) në 70 (i mesëm). Ky reduktim vjen si pasojë e transparencës, nivelit gjithnjë e në rritje të publikimit të rezultateve të auditimit, trajtimi i letrave të popullit, botimet dhe rritja e prezencës së KLSH në media.

4.2 Risqe të reduktuara në çdo departament auditimi

Elementi numër 42 në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike mbi *“Nxitja e përgjegjshmërisë publike nga auditimi”* është reduktuar duke ruajtur nivelin e mesëm nga 60 (i mesëm) në 50 (i mesëm).

Elementi numër 83 në Departamentin e Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore mbi *“Parashikime jo realiste mbi të ardhurat vjetore dhe mujore në organet e pushtetit vendor”* është reduktuar duke reduktuar nivelin nga 90 (i lartë) në 70 (i mesëm).

Elementi numër 108 në Departamentin e Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit mbi *“Të meta dhe mangësi të studimeve në projekte mjedisore”*, është reduktuar duke ruajtur nivelin e lartë, nga 90 (i lartë) në 80 (i lartë).

4.3 Risqe të shtuara për çdo departament auditimi

Elementi numër 94 në Departamentin e Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit mbi *“Keqadministrim i të dhënave në regjistrimin e pronave të subjekteve fizik dhe juridik”* është rritur duke ruajtur nivelin e tij të mesëm, nga 45 (i mesëm) në 50 (i mesëm).

Elementi numër 99 në Departamentin e Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit mbi *“Administrimi i fondeve të buxhetit të shtetit i destinuar për kompensimin në vlerë të pronareve”* është rritur duke ruajtur nivelin mesatar, nga 50 (i mesëm) në 60 (i mesëm).

Elementi numër 102 në Departamentin e Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit mbi *“Moszbatimi i kriterëve ligjorë në procesin e legalizimeve”*, është rritur duke ruajtur nivelin mesatar, nga 55 (i mesëm) në 70 (i mesëm).

Elementi numër 103 në Departamentin e Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit mbi *“Cenimi i pronarëve legjitim gjatë procesit të legalizimit”*, është rritur duke ruajtur nivelin mesatar, nga 30 (i mesëm) në 50 (i mesëm).

4.4 Elementë të shtuar të risqeve

Çdo analizë institucionale dhe vlerësimi i riskut është i plotë nëse si pasojë e procesit kemi njëkohësisht rivlerësime në rritje dhe në rënie të perceptimit për riskun. Vlerësimi i plotë përfshin gjithashtu shtimin e elementëve të rinj, të pa marrë në konsideratë më parë, elementë që burojnë nga ndryshimi i vazhdueshëm i mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të institucionit. Risqet e departamentit të auditimit IT dhe investimeve të huaja risqet nga numri 62 në numrin 72 janë rigrupuar dhe ridimensionuar. Detajomi i tyre shfaqet në këtë pjesë të matricës së risqeve.

Nr.	Përshkrimi i riskut (i brendshëm apo i jashtëm)	Risku para kontrollit, klasat 100-80/ 79-50/ 49-0	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontroleve ekzistuese	Nevoja për kontrole të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshllëqet	Zotëruesi i Riskut	Ndryshimet ne risk nga detyra e fundit
a	b	c	d	e	f	g	h	i
Politik	Mos ndërgjegjësimit dhe inertësia e administratës shtetërore	70 (i mesëm)	Rritja e transparencës, publikimi i rezultateve të auditimit, trajtimi i letrave të popullit, botimet dhe rritja e prezencës së KLSH në media	60 (mesëm)	po	Rritja e pjesëmarrjes në media, botimet shkencore dhe informative, konferencat shkencore	KLSH	<i>konstant</i>
Ekonomik	Kufizime të buxhetit financiar	60 (i mesëm)	Hartimi i Projekt Buxhetit të aftë për të përballuar nevojat financiare të KLSH për ushtrimin normal të veprimtarisë audituese	50 (mesëm)	po	Mbajtja nën kontroll e Buxhetit dhe përpilimi I kërkesave buxhetore në kohë dhe të argumentuara	KLSH	<i>konstant/ rënie</i>
Social	Shkallë e ulët e ndërgjegjësimit të grupeve të interesit dhe publikut për rolin dhe funksionin e auditimeve të KLSH	70 (i mesëm)	Rritja e transparencës, publikimi i rezultateve të auditimit, trajtimi i letrave të popullit, botimet dhe rritja e prezencës së KLSH në media	60 (i mesëm)	po	Hartimi, miratim dhe zbatimi i Strategjisë së Komunikimit, thellimi dhe intensifikimi i veprimtarive të botimeve, publikimeve dhe prezencës në media		
Teknologjik	Kompleksiteti I sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në subjektet e auditimit	70 (i mesëm)	Aplikimi i auditimeve të teknologjisë së informacionit	60 (mesëm)	po	Trajnimi i materialeve të metodologjisë të auditimit të IT, pjesëmarrje në auditime pilot		
	Sistemet e reja të menaxhimit dhe	70(i mesëm)	Aplikimi i teknologjisë së informacionit në	60 (mesëm)	po	Trajnimi i stafit, investimi në		

Nr.	Përshkrimi i riskut (i brendshëm apo i jashtëm)	Risku para kontrollit, klasat 100-80/ 79-50/ 49-0	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	Nevoja për kontrolle të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshllëqet	Zotëruesi i Riskut	Ndryshimet ne risk nga detyra e fundit
a	b	c	d	e	f	g	h	i
	përpunimit elektronik të të dhënave në KLSH		informacionin në institucion			teknologjinë e ruajtjes së informacionit		
Ligjor/rregullator	Kuadër ligjor me mangësi, jo i përshtatshëm në praktikë dhe që ndryshon në vazhdimësi	90 (i lartë)	Rritja e rekomandimeve për përmirësimin e bazës ligjore,	70 (lartë)	Po	Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve për ndryshimin e bazës ligjore		
Ambientit	Mungesë e hartimit dhe zbatimit të politikave për mbrojtjen e ambientit	90 (i lartë)	Kryerja e auditimeve të ambientit dhënia e rekomandimeve të përshtatshme	70 (lartë)	Po	Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të ambientit. Plotësimi i kushteve për kryerjen e auditimeve eficiente dhe dobiprurëse të ambientit (metodologji/përshtatja me ISSAI përkatës dhe trajnimi)		
A 2. Risqe që lidhen me fushat e vlerësuara e risk më të lartë për auditimet e KLSH								
1	Mbulimi jo i mjaftueshëm me auditim i enteve publike	80 (i lartë)	Rritja e nivelit të performancës së punës audituese, metodologjise së riskut	60 (i mesëm)	Po	Rritja e numrit të personelit auditues dhe angazhimi me i madh i stafit auditues	Parlament KLSH	rënie
2	Mungesa e ndërgjegjësimit të nivelit të lartë menaxherial të	90 (i lartë)	Auditimi i zbatimit të legjislacionit dhe lënia e rekomandimeve për titullarët e subjekteve	70 (lartë)	Po	Me rekomand. e auditimit të rritet statusi MFK, në Sektorin Publik dhe	Sekretari i Përgjith, Drejtorët e Dep të	rënie

Nr.	Përshkrimi i riskut (i brendshëm apo i jashtëm)	Risku para kontrollit, klasat 100-80/ 79-50/ 49-0	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	Nevoja për kontrolle të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshllëqet	Zotëruesi i Riskut	Ndryshimet ne risk nga detyra e fundit
a	b	c	d	e	f	g	h	i
	sektorit publik mbi nevojën dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollit		publike			inkurajim nga KLSH si organi më i lartë i auditimit, për rritje të ndërgjegjes, mbështetje nga nivelet e ndryshme menaxherial.	Auditimit, subjektet e audituara	
3	Risku rregullator	60 (i mesëm)	Shkëmbimi dhe përditësimi informacionit lidhur me ndryshimet e shpeshta të bazës rregullatorë	50 (i mesëm)	Po	Trajnim në fushat që ndryshojnë dhe që janë nën auditim nga kjo drejtori Kujdesi me procedura monitorimi për përditësimin me ndryshimet	Dep e Auditimit, Drejtoria Juridike dhe subjektet e audituara	rënie
4	Hartimi i programeve ekonomiko - financiare me mangësi në të ardhura, shpenzime dhe numër të punonjësve.	30 (i ulët)	Realizimet e mëparshme, bashkërendim i punës me dikasteret, marrja në konsideratë e investimeve dhe kërkesave aktuale, përdorimi me efektivitet i burimeve	10 (i ulët)	Jo	Trajnim në fushat që ndryshojnë dhe që janë nën auditim nga kjo drejtori Kujdesi me procedura monitorimi për përditësimin me ndryshimet	Subjektet e audituara/ Dep Auditimi	rënie
5	Moszbatimi i kriterëve ligjore për pagat dhe shpërblimet	30 (i ulët)	Verifikimi i zbatimit të kriterëve ligjore për pagat dhe shpërblimet, analiza shkakut, lidhja shkak – pasojë	20 (i ulët)	Jo	Trajnim në fushat që ndryshojnë dhe që janë nën auditim nga kjo drejtori Kujdesi me procedura monitorimi për përditësimin me ndryshimet	Subjektet e audituara/ Dep Auditimi	rënie

Nr.	Përshkrimi i riskut (i brendshëm apo i jashtëm)	Risku para kontrollit, klasat 100-80/ 79-50/ 49-0	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	Nevoja për kontrolle të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshllëqet	Zotëruesi i Riskut	Ndryshimet ne risk nga detyra e fundit
a	b	c	d	e	f	g	h	i
6	Moszbatimi i afateve dhe kritereve të përcaktuara në kontratë për shërbime, mallra dhe punime	50 (i mesëm)	Verifikimi i kontratave për shërbime, mallra dhe punime	30 (i ulët)	Po	Verifikimi i zbatimit rekomandimeve	Subjektet e audituara/ Dep Auditimi	rënie
7	Moszbatimi i fondit vjetor limit në blerjet me vlera të vogla	30 (ulët)	Verifikimi prokurimeve ne blerjen me vlera të vogla, rekomandime nga KLSH	10 (ulët)	Jo	-	Subjektet e audituara/ Dep Auditimi	rënie
8	Mangësitë në dokumentet mbështetës të veprimeve financiare	10 (ulët)	Verifikimi i formatit dhe përmbajtjes së dokumenteve mbështetës të veprimeve financiare	5 (ulët)	Jo	-	Subjektet e audituara/ Depa Auditimi	rënie
9	Gabimet e mundshme në mbajtjen e evidencës kontabile	30 (ulët)	Verifikimi i saktësisë së evidencës kontabile, rekomandime	10 (ulët)	Jo	-	Subjektet e audituara/ Dep Auditimi	rënie
10	Mos regjistrimi në kontabilitet i asetëve të përfituara nga zbatimi i investimeve/ projekteve	30 (mesëm)	Verifikimi në dokumentet e kontabilitetit i asetëve të përfituara nga përfundimi i zbatimit të projekteve	5 (ulët)	Jo	-	Subjektet e audituara/ Dep Auditimi	rënie
11	Risku i lëvizjeve të stafit për arsye	40 (mesëm)	Kontrolli i zbatimit të legjislacionit dhe	30 (mesëm/ ulët)	Po	Legjislacioni dhe standardet	Subjektet e audituara/	rënie

Nr.	Përshkrimi i riskut (i brendshëm apo i jashtëm)	Risku para kontrollit, klasat 100-80/ 79-50/ 49-0	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	Nevoja për kontrolle të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshllëqet	Zotëruesi i Riskut	Ndryshimet ne risk nga detyra e fundit
a	b	c	d	e	f	g	h	i
	politike dhe niveli jo i kënaqshëm i profesionalizimit të tij në subjektet e auditimit		caktimit të kriterëve për konkurrimet			ndërkombëtare për kualifikimin e përhershëm dhe të vijueshëm të audituesve	Dep Auditimi	
12	Risku i abuzimeve në investimet e bëra me fondet e buxhetit të shtetit dhe në veçanti në investimet e veprave strategjike	90 (lartë)	Verifikimi të gjitha praktikave ose me zgjedhje të kontratave për shërbime, mallra dhe punime. Vlerësimi i procedurave të përcaktuara në ligjin dhe udhëzimet e prokurimeve, projekte apo marrëveshje.	70 (lartë)	Po	Dhënia e rekomandimeve të auditimit për përmirësimin e sistemeve; Trajnime për audituesit mbi teknikat më të mira të kësaj fushe auditimi	Subjektet e audituara/ Dep Auditimi	rënie
13	Mangësitë në cilësi dhe afat gjatë zbatimit të kontratave për punimet civile	90 (lartë)	Verifikimi në terren i treguesve sasior dhe cilësor të përcaktuar në kontratën përkatëse	70 (lartë)	Po	Thellimi i kontrolleve dhe rekomandime përkatëse	Subjektet e audituara/ Dep Auditimi	rënie
14	Moszbatimi i rekomandimeve nga subjektet e audituara	30 (mesëm/ ulët)	Verifikimi periodikisht i zbatimit të detyrave të lëna nga auditimet	80 (lartë)	Po	Rritja e transparencës në media, forcimi i lidhjeve dhe bashkërendimi i përpjekjeve me auditin e brendshëm.	Subjektet e audituara/ Dep Auditimi	rënie
15	Mangësitë në	60 (lartë/	Auditime nga Min. Fin.	50 (mesëm)	Po	Verifikim i zbatimit te	NJQH per	rënie

Nr.	Përshkrimi i riskut (i brendshëm apo i jashtëm)	Risku para kontrollit, klasat 100-80/ 79-50/ 49-0	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	Nevoja për kontrolle të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshllëqet	Zotëruesi i Riskut	Ndryshimet ne risk nga detyra e fundit
a	b	c	d	e	f	g	h	i
	funksionimin e Auditimit të brendshëm	mesëm)	dhe KLSH: Verifikimi në se janë zbatuar standardet, vlerësim i veprimtarisë së auditit të brendshëm, etj.			rekomandimeve, auditime të tjera për funksionimin e këtyre strukturave	AB dhe Subjektet e audituara/ Departamenti Auditimi	
16	Sigurimi i pavarësisë dhe profesionalizmit së Auditimit të brendshëm, rrit shkallën e besueshmërisë së KLSH ndaj tij dhe optimizon punën audituese.	80 (lartë)	Vlerësim i performancës së strukturave të auditimit të brendshëm, zbatimit të standardeve, kartës së auditimit të brendshëm	60 (lartë/ mesëm)	Po	Verifikimi i zbatimit të standardeve të auditimit lidhur me pavarësinë funksionale të auditimit; Rekomandimet e KLSH për rritjen e rolit, nivelit prof. të audituesve të brendshëm	Min. e Fin. Subjektet e auditimit	rënie
17	Zhvillimi i metodologjisë audituese	30 (mesëm)	Përditësimi dhe plotësimi i dokumenteve strategjik, mbulimi i të gjithë stafit me trajnim	20 (mesëm)	po	Përfshirja e Drejt metodologjisë në procesin e kontrollit të cilësisë, zgjerimi i stafit të drejtorisë së metodologjisë dhe zhvillimit	Drejtoria e metodologji së dhe zhvillimit	rënie
18	Lëvizjet e personelit në institucion	20 (ulët)	Politika të mirë stabilizuara në rekrutimit, vlerësimi i periudhës së provës dhe trajnimeve e testime	10 (ulët)	po	Përzgjedhja e stafit përzgjedhës, politika të mirë stabilizuara të përzgjedhjes së stafit, monitorim më i madh i procesit	DBNJ/ DMZH	rënie

Nr.	Përshkrimi i riskut (i brendshëm apo i jashtëm)	Risku para kontrollit, klasat 100-80/ 79-50/ 49-0	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	Nevoja për kontrolle të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshllëqet	Zotëruesi i Riskut	Ndryshimet ne risk nga detyra e fundit
a	b	c	d	e	f	g	h	i
19	Sigurimi i etikës, pavarësisë dhe integritetit të stafit auditues në institucion	30 (mesëm)	Familjarizim me subjektin auditues, performanca në punë	20 (mesëm)	po	Rotacione periodike të stafit nëpër Dep, trajnim testim i vazhdueshëm i dijeve	Dep e auditimit	rënie
20	Risku i inefficiencës në punën audituese	30 (Mesëm/ulët)	Vlerësimi kosto/përfitim Planifikimi dhe ndjekja e zbatimit të koston së auditimit krahasur me përfitimet e tij	20 (ulët)	Po	Trajnime mbi teknikat me te mira te auditimit me qëllim rritjen e cilësisë, eficiencës	Dep e auditimit; drejt.juridik e dhe zbat. të standard	rënie
21	Nivel jo i kënaqshëm i profesionalizimit të stafit	40 (mesëm)	Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare për kualifikimin e përhershëm dhe të vijueshëm të audituesve.	30 (Mesëm/ulët)	Po	Zbatimi i Strategjisë së zhvillimit dhe i programeve efektive të trajnimit në KLSH dhe jashtë saj	Dep e auditimit; drejtoria e burimeve njerëzore	rënie
22	Risku i stafit të ri	10 (ulët)	Ligji ka kritere punësimi: Statusi i Nëpunësit civil bazohet mbi meritën	5 (i ulët)	Jo	Kërkesat për rekrutim duhet të jenë të larta me qëllim tërheqjen e kontingjenteve me kualifikim të lartë	Sekretari i Përgjithshëm, drejtoria e burimeve njerëzore	rënie
23	Metoda e punës dhe niveli i drejtimit të punës nga drejtori, krye audituesi.	30 (mesëm/ulët)	Kontrolli i cilësisë brenda dep.; diskutimet me grupet e auditimit	20 (i ulët)	Jo	Zbatimi i detyrave të përcaktuara në Rreg. E KLSH	Drejtorët e Dep/drejtorive	rënie
24	Rekomandime jo të	30 (i	Kontrolli i cilësisë së	20 (i ulët)	Jo	Çdo dosje auditimi	Dep e	rënie

Nr.	Përshkrimi i riskut (i brendshëm apo i jashtëm)	Risku para kontrollit, klasat 100-80/ 79-50/ 49-0	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	Nevoja për kontrolle të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshllëqet	Zotëruesi i Riskut	Ndryshimet ne risk nga detyra e fundit
a	b	c	d	e	f	g	h	i
	plota në materialet e auditimit	Mesëm/ulët)	auditimeve dhe dhënia e sugjerimeve për rregullimet përkatëse			rishikohet nga drejtoria juridike	auditimit dhe drejtoria juridike	
25	Risku i komunikimit me median dhe publikun	50 (i Mesëm)	Udhërrëfyese i AB ka specifikuar standardet e Raportimit të rezultateve të auditimit	40 (mesëm)	Po	Forcimi i kërkesave për zbatimin e rregullave dhe standardeve ne fushën e raportimit	Drejtoria e Komunikimit dhe mardh. me jashtë	rënie
A. 2 - Risqe identifikuar nga çdo departament auditimi								
I. Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore								
Objektivi: Auditimi mbi funksionimin e menaxhimit financiar, kontrollit dhe strukturave të auditimit të brendshëm në institucionet e administratës së lartë publike dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes.								
26	Mospërputhja me termat e Aktit të Buxhetit dhe paraqitja e kërkesave buxhetore jo ne standardet e kërkuara	30 (mesëm/ulët)	Auditime të vlerësim paraprak i indikatoreve të zbatimit të buxhetit të vitit paraardhës - nevoja për përmirësimin e udhëzimeve për përgatitjen e buxhetit.	20 (Ulët)	Jo	Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet	Min. Fin. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, subjektet e audituara, Dep Auditimit	rënie
27	Pagesa të pasakta ose të çrregullta për shpenzime e administrimit korente apo zhvillimore	40 (mesëm)	Ndarja e detyrave dhe personelit përgjegjës midis fillimit të urdhrit, pagesave dhe kontrollit të pagesave;	30 (mesëm/ulët)	Po	Auditime të radhës	Subjektet e auditimit (sektorët e buxhetit apo te financës) Dep Auditimit	rënie

Nr.	Përshkrimi i riskut (i brendshëm apo i jashtëm)	Risku para kontrollit, klasat 100-80/ 79-50/ 49-0	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	Nevoja për kontrolle të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshllëqet	Zotëruesi i Riskut	Ndryshimet ne risk nga detyra e fundit
a	b	c	d	e	f	g	h	i
28	Mungesa e përpilimit të pasqyrave të konsoliduara financiare	80 (i lartë)	Rekomandime për përmirësimin të gjendjes dhe adresim tek autoritetet përgjegjëse dhe institucionet ndërkombëtare	70 (i lartë)	Po	Miratimi dhe aplikimi i standardeve të mbajtjes së kontabilitetit	Min. Fin, Përgjithshme e Buxhetit,	
29	Shkelje në të ardhurat nga qiratë dhe privatizimet e pronës publike	40 (mesëm)	Auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në këtë fushë, rekomandime për përmirësim	30 (mesëm/ulët)	Po	Programe Auditimi	Subjektet e audituara/ Dep Auditimi	rënie
30	Pasaktësi në llogaritjen e përfitimeve nga skema e sigurimeve shoqërore.	60 (lartë/mesëm)	Software për kontrollin automatik të pagesave. Auditimi i pagesave dhe rrjedhës së parave, periodikisht e progresivisht.	30 (mesëm/ulët)	Po	Programe informatike Regjistrin kombëtar të pensioneve, Kualifikim i 20kontrolloreve për përdorim. e programeve informatike.	ISSH dhe degët vartëse / Dep Auditimi	rënie
31	Mosrespektimi në përdorimin e fondeve të miratuara sipas strukturës së shpenzimeve të kujdesit shëndetësor	40 (mesëm)	Vlerësim i zbatimit të fondeve dhe zbatimit të detyrave të auditimit të mëparshëm, përmirësimi i termave të përgatitjes së buxhetit.	30 (mesëm/ulët)	Jo	-	ISKSH dhe degët vartëse / Dep Auditimi	rënie
32	Mos realizimi i investimeve të parashikuara dhe zbatimi i ligjit të	50 (mesëm)	Vlerësimi i realizimit të investimeve në strukturë, analiza shkaqeve të mosreal, impakti në	40 mesëm	Po	Rekomandim dhe auditime të radhës	Ministria e Financave	rënie

Nr.	Përshkrimi i riskut (i brendshëm apo i jashtëm)	Risku para kontrollit, klasat 100-80/ 79-50/ 49-0	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	Nevoja për kontrolle të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshllëqet	Zotëruesi i Riskut	Ndryshimet ne risk nga detyra e fundit
a	b	c	d	e	f	g	h	i
	buxhetit		prodhim dhe në të ardhurat e buxhetit					
33	Hartimi dhe zbatim i programeve financiare të zhvillimit të paargumentuara dhe ndryshueshmëria e bazës ligjore	60 (I lartë/ mesëm)	Analizë e treguesve të programeve dhe auditim i ligjshmërisë në zbatimin e tyre	50 (mesëm)	Po	Rekomandim dhe auditime të radhës	, Min. Mbrojtjes, Dep Auditimi	rënie
34	Reformimi i administratës dhe i kuadrit rregullator në kuadër të <i>acquis qommunautaire</i>	60 (mesëm)	Kuadri i ri rregullator, reformimi i administratës publike, strategjia e PFM	60 (mesëm)	po	Njohja e stafit me strategjinë e reformimit, përshtatja e planit auditues dhe programeve të auditimit	Institucionet qendrore, BSH,DAP, INSTAT	rënie
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike								
Objektivi Auditimi i veprimtarisë së Shoqërive Publike,								
35	Mungesa e zbatimit të kriterëve ligjore në përbërjen e bordeve drejtuese	50 (I mesëm)	Ballafaqimi i kriterëve rregullator me ato të zbatuara në fakt nga subjekti	20 (I ulët)	Jo	-	Subjektet e audituara / Dep Auditimit	rënie
36	Vendim-marrje nga bordet drejtuese në mungesë të dhënave të mjaftueshme dhe të pabazuara ligjërisht	80 (I lartë)	Analizë e plotë, duke përfshirë dhe relacionet përkatëse për vendim-marrjen.	60 (I lartë/ I mesëm)	Po	Rekomandime të KLSH: Konfirmimi i raportimit në Institucionin qendror përkatës	Subjektet e audituara / Dep Auditimit	Rënie
37	Moszbatimi i	30 (I mesëm)	Verifikimi me zgjedhje i	20 (I ulët)	Jo		Subjektet e	Rënie

Nr.	Përshkrimi i riskut (i brendshëm apo i jashtëm)	Risku para kontrollit, klasat 100-80/ 79-50/ 49-0	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	Nevoja për kontrolle të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshllëqet	Zotëruesi i Riskut	Ndryshimet ne risk nga detyra e fundit
a	b	c	d	e	f	g	h	i
	kritereve ligjore për detyrimet fiskale në afat dhe në kritere		zbatimit të afatit dhe në kritereve për detyrimet fiskale			-	audituar / Dep Auditimit	
38	Risku i trashëguar	40 (I mesëm)	Evidentimi i faktorëve që ndikojnë negat. në veprimtarinë e subjekteve megjithëse menaxhimi i burimeve mund të jetë i mirë; rekomandime.	30 (I mesëm/ I ulët)	Po	Kontroll zbat. Rekomand.	Dep i auditimit të performancë, subj. auditim.	Rënie
39	Ndryshime të rëndësishme në organizatë nga auditimi	50 (I mesëm)	Përmirësimi nga rezultati i auditimit i programeve të zhvillimit, menaxh., kapacitetit të shërbimeve, etj.	30 (I mesëm/ I ulët)	Jo	-	Dep i auditimit të performancë 69, subj. auditim.	Rënie
40	Cilësia e drejtimit të organizatës, funksionit, etj.	50 (I mesëm)	Analiza e hollësishme e informacionit për veprimtarinë e organizatës	40 (i mesëm)	Po	Verifikime të zbatimit të rekomandim, auditim.	Dep i auditimit të performancë subj. auditim.	rënie
41	Kontributi i auditimit në menaxhimin financiar dhe uljen e kostos	40 (I mesëm)	Kontrolli i evidencës së mbledhur lidhur me ekonomikitetin	20 (I ulët)	Po	Verifikime të zbatimit të rekomandim, auditim.	Dep i auditimit të performancë, subj. auditim.	Rënie
42	Nxitja e përgjegjshmërisë publike nga	50 (I mesëm)	Propagandimi në mediat kryesore i konkluzioneve të auditimit	30 (I mesëm/ I ulët)	Jo	-	Dep i auditimit të performancë	Rënie

Nr.	Përshkrimi i riskut (i brendshëm apo i jashtëm)	Risku para kontrollit, klasat 100-80/ 79-50/ 49-0	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	Nevoja për kontrolle të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshllëqet	Zotëruesi i Riskut	Ndryshimet ne risk nga detyra e fundit
a	b	c	d	e	f	g	h	i
	auditimi						subj. auditim.	
43	Mos zbatim i Rreg. brendshme, standardeve të auditimit, Kodit të Etikës	30 (Mesëm/ulët)	Kontrolli i cilësisë brenda dep, si dhe nga struktura përkatëse	20 (I ulët)	Po	Trajnime sipas llojit dhe fushave të auditimit për stafin auditues	Drejtorët e dep të auditimit, Stafi auditues	Rënie
44	Mungesë kapacitetesh për auditimin e IT në kushtet e informatizimit të operacioneve	60 (i mesëm)	Rekrutimi i stafit të kualifikuar dhe me eksperiencë ('ndër më të mirët')	40 (i lartë)	Po	Trajnim i audituesve dhe plotësim i stafit me auditues që kanë njohuri për IT	Sekretari i Përgjithshëm, DBNJ, drejtorët e Dep	Rënie
45	Metoda e punës dhe niveli i drejtimit të punës nga drejtori, krye audituesi.	30 (mesëm/ulët)	Kontrolli i cilësisë brenda dep.; diskutimet me grupet e auditimit	20 (i ulët)	Jo	Zbatim i detyrave të përcaktuara në Rreg. E KLSH	Drejtorët e Dep/drejtorive	Rënie
46	Rekomandime jo të plota në materialet e auditimit	30 (i Mesëm/ulët)	Kontrolli i cilësisë së auditimeve dhe dhënia e sugjerimeve për rregullimet përkatëse	20 (i ulët)	Jo	Çdo dosje auditimi rishikohet nga drejtoria juridike	Dep e auditimit dhe drejtoria juridike	Rënie
47	Risku i komunikimit me median dhe publikun	50 (i Mesëm)	Udhërrëfyesi i AB ka specifikuar standardet e Raportimit të rezultateve të auditimit	40 (mesëm)	Po	Forcimi i kërkesave për zbatimin e rregullave dhe standardeve ne fushën e raportimit	Drejtoria e Komunikimit dhe mardh. me jashtë	Rënie
48	Kuptimi jo i drejtë i	30	Ballafaqimi i	20 (ulët)	Jo	-	Drejtoria e	rënie

Nr.	Përshkrimi i riskut (i brendshëm apo i jashtëm)	Risku para kontrollit, klasat 100-80/ 79-50/ 49-0	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	Nevoja për kontrolle të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshllëqet	Zotëruesi i Riskut	Ndryshimet ne risk nga detyra e fundit
a	b	c	d	e	f	g	h	i
	raporteve të investigimit dhe auditimit të brendshëm	(Mesëm/ulët)	problemeve të shtjelluara me kërkesat ligjore dhe Rregulloren e brendshme				auditimit të brendshëm	
49	Mosrealizimi i strategjisë dhe objektivave në drejtim të teknologjisë së informacionit	50 (i Mesëm)	Mbështetja me investime dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të punës së pajsijeve	20 (ulët)	Jo	Trajnim të punonjësve për çështjet e IT	Dep i Politikave të Auditimit	Rënie
50	Përvetësimi i programeve të trajnimit dhe zbatimi i tyre në punën audituese	50 (i Mesëm)	Kontrolli i procedurave të trajnimit; Kontrolli i cilësisë gjatë proceseve të trajnimit.	30 (mesëm/ulët)	Jo	Analiza e nevojave për trajnim, Rishikimi i programeve të trajnimit bazuar në standarde;	Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit	Rënie
51	Vijimësia e aktivitetit dhe Rikuperimi i aksidenteve	50 (i Mesëm)	Siguria Fizike dhe mjedisit Kontrolli i aksesit, në sistemet e IT, mirëmbajtja, zbatimi i politikave të vijimësisë së aktivitetit, zbatimi i Planit të restaurimit të rikuperimit të aksidenteve	20 (I ulët)	Jo	-	Drejtoria e logjistikës dhe IT, stafi	Rënie
52	Reformimi i	30 (i mesëm)	Kuadri i ri rregullator,	30 (i mesëm)	po	Njohja e stafit me	Institucionet	Rënie

